

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Dr.sc.Driton Muharremi, Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Syzana Goxhuli, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit K.P. nga Ferizaji, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.192/18 datë 30.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 18.12.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.192/18 datë 30.10.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj-departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.192/18 datë 30.10.2018, të akuzuarin K.P. e ka shpallur fajtorë për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së për çka e ka gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 4 muaj i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi, në të cilin do të llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 17.09.2018 deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar. Konform nenit 374 par.3 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme arma-pistoletë e tipit Ekol Special, kalibri 7.65mm me numër serik EU 1840185. Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 euro në afat prej 15 ditëve nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

- Prokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata Apelit aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit K.P. të i shqiptoj dënim me burg në kohëzgjatje më të madhe duke pas parasyshë specifikat e këtij rasti me të cilin do të arrojë qëllimi i dënimit.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në të cilën nuk mori pjesë askush nga palët e ftuara me rregull.

- Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.513/2018 të dt. 12.11.2018 ka propozuar që ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore të aprovohet dhe aktgjykimi ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit të shqiptohet dënimi më i lartë me burg efektiv.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa është e pa bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. As gjendja faktike nuk qe objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase nuk është kontestuar me ankesë, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në frymë të pretendimeve ankimore.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të Prokurorit të Prokurorisë Themelore me Ferizaj lidhur me vendimin për dënimi kjo gjykatë konsideron se ankesa është e pa bazuar. Në ankesën e Prokurorisë nuk ceket ndonjë rrethanë e re e që do të ndikonte në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit. Prokuroria në ankesë thekson se edhe pse është vërtetuar gjendja faktike se i njëjti e ka kryer veprën gjykata i ka shqiptuar dënim të butë krahasuar me peshën e veprës penale të kryer, përgjegjësinë e të akuzuarit si dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, ku i akuzuari ka mbajtur armen për faktin se është ne hasmëri me familjen T. ngase ne vitin 2013 si i mitur kishte pasur problem me një person të familjes T. i moshës 17 vjeçare. Sipas prokurorisë gjykata ka pas parasysh vetëm rrethanat lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë duke shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer ndërsa si rrethane rënduese nuk ka gjetur asnjë rrethane.

Mirëpo, Gjykata e Apelit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe atë pranimin e fajësisë që në shqyrtimin fillestar, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën e kryer, nuk është vërtetuar se ka qenë me parë i dënuesi për ndonjë aktgjykim të formës së prerë e që këto rrethana i ndërlidh me rrethanat personale të moshës së re e ne mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale në veçanti pati parasysh se i pandehuri ka deklaruar se armen e ka blerë me qellim që të mbrohet nga familja T. me të cilën janë ne hasmëri, vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të

akuzuarit si ekzekutor, gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimin e paraparë ligjor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.540/18, më 18.12.2018

Procesmbajtës,
Syzana Goxhuli

Kryetare e kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi_____

3. Abdullah Ahmeti _____